



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETAR I K.K.T-së
Z. EDI RAMA

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Z. BLENDI KLOSI

**PLANI I DETAJUAR I ZONËS ME RËNDËSI KOMBËTARE (PDZRK)
VJOSË-NARTË, BASHKIA VLORË**

RREGULLORJA E DETAJUAR E PLANIT

Miratur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. __, Datë __.__.2021

Hartuar nga

AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT (AKPT)



Përmbajtja

1	KREU I – Qellimi dhe Objekti i Rregullores se Planit te Detajuar per Zonen e Rendesise Kombetare Vjosë – Nartë, Bashkia Vlorë.....	5
1.1	Dispozita të përgjithshme.....	5
1.2	Përkufizimet dhe shpjegimi i termave.....	6
1.3	Shpjegimi i Kodeve.....	7
2	KREU II - Rregullat bazë për zhvillimin	8
2	Ndarja e njësive strukturore në nënnjësi strukturore.....	8
3	Përdorimi i tokës.....	8
4	Mënyra e ndërhyrjes në territor	8
5	Vendparkimet.....	9
6	Bashkimi i parcelave për qëllime zhvillimi.....	9
7	Distanca ndërmjet ndërtimeve dhe kufirit të pronës	9
8	Distancat e ndërtimeve nga trupi i rrugës	9
9	Distancat e ndërtimeve nga trupat ujorë, përcaktimi i Vijës Blu.....	10
3	KREU III - Rregullat Bazë për mbrojtjen e mjedisit dhe peizazhit	11
11	Rregulla për aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara në zonë	11
4	KREU IV - Rregullat bazë për infrastrukturën	11
12	Infrastruktura e transportit	11
13	Infrastrukturat inxhinierike.....	14
5	KREU V - Rregullat e zhvillimit për nënnjësitë strukturore	15
5.1	Njësitë strukturore të Sistemit Urban dhe Infrastrukturor.....	15
5.2	Njësitë strukturore të Sistemit Ujor	16
5.3	Njësitë strukturore të sistemit Bujqësor	17
5.4	Njësitë strukturore të Sistemit Natyror	17
5.5	Njësitë strukturore të Sistemit Bujqësor me shërbime agroturistike.....	18
6	KREU VI - Dispozita kalimtare dhe të fundit.....	20
6.1	Monitorimi i zbatimit të PDZRK-së.....	20
6.2	Rishikimi i PDZRK-së	20
6.3	Zgjidhja e Konfliktëve dhe mospërputhjeve	20
6.4	Hyrja në fuqi	20
7	Shtojca I – Referenca Ligjore	20

Lista e Hartave

Harta 1. Kufitë e njësive strukturore, objekt i PDZRK-së	5
--	---

Lista e Figurave

Figura 1 Rruga Kombetare	12
Figura 2 Rruge interurbane kryesore	
Figura 3 Rruge interurbane dytesore (A)	12
Figura 4 Rruge interurbane dytesore (B)	
Figura 5 Rruge interurbane terciare	12
Figura 6 Rruge urbane dytesore (A)	
Figura 7 Rruge urbane dytesore (B)	13
Figura 8 Rruge urbane terciar (A) (Rruge lokale)	
Figura 9 Rruge urbane terciar (B) (Rruge lokale)	13

Lista e Tabelave

Tabela 1 Njësitë strukturore të Sistemit Infrastruktural	15
Tabela 2 Njësitë strukturore të Sistemit Bujqësor	17
Tabela 3 Njësitë strukturore të Sistemit Natyror	18
Tabela 4 Njësitë strukturore të Sistemit Natyror dhe Shërbime Ekoturistike	18
Tabela 5 Njësitë strukturore të Sistemit Bujqësor me shërbime agroturistike	19

Lista e AKRONIMEVE

AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
PDZRK	Plan i Detajuar për zonë të Rëndësisë Kombëtare
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar Shqipëria 2030
PINS Bregdeti	Plani i Integrur Ndersektorial i Bregdetit
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
NO	Novoselë
KSHT	Koeficienti i Shfrytëzimit të Tokës
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

1 KREU I – Qëllimi dhe Objekti i Rregullores së Planit të Detajuar për Zonën e Rendesise Kombetare Vjosë – Nartë, Bashkia Vlorë

1.1 Dispozita të përgjithshme

1.1.1 Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, normave dhe standardeve të hartuara në përputhje me Rregulloren së Planifikimit të Territorit¹ dhe Rregulloren e Zhvillimit të Territorit², të cilat do të udhëheqin zhvillimin dhe transformimin, në zbatim të parashikimeve të Planit të Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) Vjosë – Nartë, Bashkia Vlorë sipas kufijve territorial të përcaktuar në vijim të kësaj rregulloreje.

1.1.2 Qëllimi

Qëllimi i Rregullores është të përcaktojë rregullat e domosdoshme për zbatimin e Planit të Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) Vjosë – Nartë, Bashkia Vlorë

1.1.3 Territori subjekt i PDZRK-së

Kjo rregullore është e detyrueshme të zbatohet në sipërfaqen e zonës së trajtuar nga Plani i Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) Vjosë – Nartë, njësia administrative Novoselë dhe pjesërisht njësia administrative Qendër, Bashkia Vlorë sipas Hartës 1.

1.1.4 Zbatueshmëria

Rregullorja e PDZRK jep rregulla shitesë, të cilat mbizotërojnë mbi rregullat e përcaktuara nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vlorë, ndërkohë për ç'do çështje tjetër që lidhet me zhvillimet në territor dhe nuk trajtohen nga kjo rregullore, zbatohet Rregullorja e PPV –se Vlorë.

Zbatimi i kësaj rregulloreje është i detyrueshëm për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë aktivitetin e tyre, kanë pronësi dhe/ose banojnë në territorin subjekt të PDZRK-se, sipas sipërfaqes dhe kufirit të përcaktuar si më sipër.

1.1.1

1.1.5 Ligjshmëria

Kjo rregullore është në përputhje me legjislacionin e planifikimit dhe të zhvillimit dhe atë sektorial, në fuqi. Zbatueshmëria e saj kufizohet nga keto legjislacione dhe ndryshimet e tyre.

Harta 1. Kufitë e njësive strukturore, objekt i PDZRK-së

¹ Miratuar me VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, e ndryshuar

² Miratuar me VKM Nr. 408, datë 13.05.2015, e ndryshuar

1.2 Përkufizimet dhe shpjegimi i termave

1. *“Intensiteti”* – është raporti ndërmjet sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit mbi tokë me sipërfaqen e tokës në dispozicion për ndërtim.
2. *“KSHT, koeficienti i shfrytëzimit të tokës për ndërtim”* - është raporti ndërmjet sipërfaqes së gjurmës së strukturës të vendosur në parcelë/grup-parcelash me sipërfaqen e përgjithshme të parcelës/grup-parcelave, shprehur në përqindje.
3. *“Konservim”* - është procesi i ruajtjes dhe i mbrojtjes së një territori ose ndërtimi të caktuar në formën e tij ekzistuese/aktuale. Në cdo rast konservimi, treguesit ekzistues të zhvillimit mbeten të pandryshuar;
4. *“Zhvillim”* - është procesi i ndryshimit të territorit përmes zbatimit të treguesëve të rinj të zhvillimit të territorit.
5. *“Nënjësi strukturore”* – pjesë përbërëse e njësisë, që përdoret për qëllime planifikimi, gjatë planifikimit të detajuar të territorit.
6. *“Njësi strukturore”* - është njësi strukturore e territorit që përdoret për qëllime planifikimi, pjesë përbërëse e zonës.
7. *“Parcelë minimale për zhvillim”* – është sipërfaqja e tokës minimale e mundshme për zhvillim mbi të cilën do të llogariten treguesit e zhvillimit në përputhje me këtë rregullore. Kjo sipërfaqe mund të përftohet pas një procesi ndarje apo bashkimi parcelash kadastrale me qëllim plotësimin e kushteve për zhvillim dhe regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme si një parcelë e re kadastrale.
8. *“Sistem territorial”* – është tërësia e elementëve territorialë gjeografikë e fizikë, natyror dhe antropologjikë, të cilët të ndërruar dhe në bashkëveprim me njëri-tjetrit formojnë një tërësi më komplekse se elementët e veçantë.
9. *“Tipologji hapësirore”* - është karakteri i një njësie strukturore bazuar në ndërthurjen e njëtrajtshmërisë së llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes së tyre në territor, skemës rrugore dhe të hapësirave publike.
10. *“Vija e kuqe”* ose *“Vija e ndërtimit”* - është kufiri i lejuar për vendosjen e një ndërtimi në raport me infrastrukturën, në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi.
11. *“Vija blu”* – vija kufizuese e zhvillimit me funksion mbrojtjen e të gjitha burimeve ujore.
12. *“Zhvillim i qëndrueshëm”³* - është zhvillimi social, ekonomik, territorial dhe mjedisor që u përgjigjet nevojave të brezave të sotëm dhe që nuk rrezikon, dëmton apo pakëson burimet për brezat e ardhshëm.

Termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet dhe termat e përcaktuara në Ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe me ato të përcaktuara në ligjet e posaçme në fuqi.

³ Zhvillimi i qëndrueshëm sipas UN, Raporti Brundtland “E ardhmja jonë e përbashkët” (1987) është “zhvillimi i cili adreson nevojat e brezit aktual të shoqërisë pa kompromentuar mundësitë e brezave të ardhshëm për të adresuar nevojat e tyre”

1.3 Shpjegimi i Kodeve

1. Kodet për Përdorimin e Tokës të përdorur në këtë rregullore janë të njëjta me ato të Shtojcës I të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar.
2. Kodet për njësitë strukturore janë marrë nga kodifikimi i njësive në dokumentin e Planit të Përgjithshëm Vendor, të Bashkisë Vlorë dhe në bazë të Shtojcës II të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit".
3. Kodet për sistemin rrugor janë përcaktuar sipas nenit 2 të Kodit Rrugor, i miratuar me Ligjin Nr. 8378 datë, 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

2 KREU II - Rregullat bazë për zhvillimin

2 Ndarja e njësive strukturore në nënnjësi strukturore

Ndarja e njësive strukturore, në nënnjësi strukturore si dhe riorganizimi i tyre bëhet me qëllim orientimin e zhvillimit të zonës që t'i përshtatet territorit, masave mbrojtëse e kushtëzimeve, si dhe interesave të zhvilluesve të tokës.

Njësitë strukturore në studim i nënshtrohen procesit të ndarjes në nënnjësi strukturore mbi bazën e të cilave kryhet procesi i zhvillimit të tyre. Nënndarja e njësive realizohet në mënyrë që të formohen zona zhvillimi me përdorime toke dhe kushte zhvillimi homogjene, me akses të drejtpërdrejtë në rrjetet e infrastrukturave, e njëkohësisht duke marrë në konsideratë edhe konfigurimin e parcelave.

3 Përdorimi i tokës

1. Të gjitha përdorimet e tokës duhet të jenë në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar e sektorial, duke i kushtuar rëndësi veçanërisht organizimit, shpërndarjes së shërbimeve, higjienës dhe shëndetit publik, mbrojtjes nga rreziqet si përmbytjet, ndotjet, zjarret etj., rrezikut natyror/forcave madhore, rrezikut teknologjik dhe në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
2. Çdo lloj ndërhyrje në territor, duhet të marrë në konsideratë rregullat dhe rekomandimet për mbrojtjen mjedisore, duhet të sigurojë brezat mbrojtës, sipas parametrave ligjorë brenda parcelës për zhvillim si dhe të gjithë infrastrukturën e ujësjellës kanalizimeve si parakusht për lejen e ndërtimit.
3. Çdo zhvillim i ri, duhet të respektojë standartet e kuadrit ligjor në fuqi, përse i përket niveleve kufi për zhurmat, ndotësit e ajrit, ujit, tokës etj.
4. Të gjitha ndërtimet e reja, rikonstruksionet, rehabilitimet dhe ndërhyrjet në infrastrukturë duhet të sigurojnë aplikimin e normave në fuqi për mbrojtjen nga zjarri, sipas ligjit Nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" dhe aktet nënligjore.

4 Mënyra e ndërhyrjes në territor

Mënyrat e ndërhyrjes në territor, sipas nënnjësive strukturore janë të mëposhtmet:

1. Konservim – për nënnjësitë strukturore me kategori bazë *N – Tokë Natyrore dhe B . Tokë Bujqësore*-. Konsiston në ruajtjen dhe mbrojtjen e territorit në formën e tij aktuale.
2. Zhvillim – për nënnjësitë strukturore me kategori bazë *S – Shërbime dhe A- banim*. Gjithashtu parashikone zhvillime të karakterit të eperkohshëm në zonat e shërbimit të plazhit si edhe struktura në shërbim të bujqësisë të tipit agroturizëm nën kategorinë EB dhe të tipit ekoturizëm nën kategorinë NAR, aty ku specifikohet edhe sipas pasaportave të dedikuara për çdo nënnjësi

5 Vendparkimet

1. Çdo zhvillim duhet të sigurojë numrin e vendparkimeve për vizitorët dhe përdoruesit. Numri i vendparkimeve për përdoruesit duhet të sigurohet brenda sipërfaqes së përgjithshme të parcelës apo grup-parcelave për zhvillim, mbi ose nëntokë.
2. Në rastet kur për realizimin e parkimeve nevojitet shtrirja e tyre mbi tokë dhe ndërthurja e sipërfaqeve të parkimeve me sipërfaqet e gjelbra, atëherë zgjidhja duhet të jetë me elementë që sigurojnë permeabilitetin e terrenit dhe parkimet duhet të kufizohen dhe integrohen me gjelbërim të mesëm dhe të lartë hijezues.
3. Numri i parkimeve që duhet të sigurohet për çdo objekt, është i lidhur dhe në përputhje me tipologjinë e strukturës së propozuar, standartin e akomodimit dhe/apo shërbimit të ofruar si dhe me menaxhimin e trafikut dhe lëvizshmërinë në zonë.

6 Bashkimi i parcelave për qëllime zhvillimi

1. PDZRK i trajton nënnjësitë të barasvlefshme me parcela për zhvillim (1 nënnjësi = 1 parcelë), referuar statusit ekzistues të pronësisë në këto nënnjësi por edhe parakushtit për zhvillim të integruar e të unifikuar për nënnjësi. Në rastin kur nënnjësia përmban më shumë se një parcelë në vetvete, parcelat duhet të bashkohen për qëllime zhvillimi.
2. Bashkimi apo/edhe ndarja e parcelave për qëllime zhvillimi kryhet me vullnetin e pronarëve të tyre përmes lejes së zhvillimit/ndërtimit, në këtë rast pasi zhvillimi i ri kërkon krijimin e një parcele të re, me formë dhe përmasa të ndryshme nga parcelat ekzistuese të cilat bashkohen. Në çdo rast ruhen kufinj të minimalë për nëndarjen dhe bashkimin e tyre sipas përcaktimeve në pasportën për zhvillimin e çdo njësie.
3. Në rastet e bashkimit të parcelave orientuar nga ky plan, përmes një leje, plani i bashkimit të parcelave, fazat e zbatimit të bashkimit dhe instrumentet e financimit duhet të jenë pjesë e projektit që shoqëron kërkesën për leje.
4. Parcelat e reja të krijuara pas procesit të bashkimit duhet të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me rrugën dhe infrastrukturën e shërbimit UKZ.

7 Distanca ndërmjet ndërtimeve dhe kufirit të pronës

Përcaktimi i distancave minimale të lejuara midis ndërtimeve dhe kufirit të pronës bëhet në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr. 283, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore".

8 Distancat e ndërtimeve nga trupi i rrugës

Përcaktimi i distancës së lejuar të ndërtimeve, me trupin e rrugës kryhet sipas përcaktimeve të VKM Nr. 408, datë 01.04.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar dhe VKM Nr.153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë".

9 Distanca e ndërtimeve nga trupat ujorë, përcaktimi i Vijës Blu

Distanca e ndërtimeve nga trupat ujorë ose vija blu është e përcaktuar në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

Në hartat e përdorimit të tokës dhe të ndarjes në nënnjësi strukturore janë zbatuar distancat e vijës blu 100m nga bregu i lumit dhe i detit si hapësira e mbrojtjes strikte, pa zhvillime dhe akse publik, dhe distanca 300m nga bregu i lumit dhe nga vija bregdetare, si zona me zhvillime të përkohshme, me struktura të lehta, me qëllim ofrimin e shërbimeve bazë për frekuentimin e zonës për qëllime turistike.

10 Rregullat për trashëgiminë kulturore

Rregullat bazë për trashëgiminë kulturore, distancat e mbrojtjes për zonat historike dhe monumentet e trashëgimisë kulturore përcaktohen nga legjislacioni përkatës në fuqi. Në zonat dhe njësitë strukturore që i përkasin kategorisë bazë Monument Kulture, ose ku gjenden struktura që i përkasin kësaj kategorie, nëse sipas ligjit të posaçëm lejohen ndërtime të reja, ato duhet të theksojnë vlerën arkitektonike të strukturës monument dhe të jenë në harmoni arkitektonike me të, si dhe të ndërtohen në distanca të tilla që e lejojnë strukturën monument kulture të mbetet plotësisht e perceptueshme në të gjitha drejtimet e saj.

11 Rregulla arkitektonike

1. Të gjitha ndërtimet e reja si dhe ndërhyrjet për mirëmbajtje të jashtëzakonshme të ndërtesave dhe hapësirave ekzistuese duhet të projektohen dhe realizohen duke patur parasysh përmirësimin e mundësisë së aksesimit dhe përdorimit për të gjitha kategoritë e qytetarëve duke dhënë zgjidhje problemeve të kapërcimit të barrierave arkitektonike në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret sektoriale.
2. Duke patur synim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përdorimin sa më të plotë të peisazhit urban nga ana e të gjithë qytetarëve dhe në veçanti nga ana e personave me aftësi të kufizuara, projektimi i ndërtesave publike dhe i hapësirave të lira duhet të marri parasysh edhe konventën e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
3. Pronarët kanë detyrë t'i mbajnë ndërtesat në kushte të përshtatshme përdorimi, pamjeje, higjienë dhe siguri sociale e mjedisore duke siguruar të gjitha ndërhyrjet e nevojshme me një kujdes të veçantë në ruajtjen dhe vlerësimin e të gjitha elementeve arkitektonike të spikatura. Në rast se mungojnë kushtet e përshtatshme të përdorimit, pamjes, higjienës dhe siguri sociale e mjedisore të cilat sjellin rrezik për sigurinë publike ose higjienën, duhen ndërmarrë të gjitha masat që parashikohen nga ligjet dhe rregulloret sektoriale.

12 Rregullat për përshtatjen e hapësirave për PAK

Rregullat për shfrytëzimin e hapësirave nga "Personat me aftësi të kufizuara" do të zbatohen në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar me vendim të KKT Nr.1, Datë 16.10.2017.

3 KREU III - Rregullat Bazë për mbrojtjen e mjedisit dhe peizazhit

11 Rregulla për aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara në zonë

Rregullat për aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara në zonë mbështeten në legjislacionin sektorial në fushën e mjedisit dhe dokumentet e planifikimit në fuqi: PPK Shqipëria 2030, PINS Bregdeti, për njësitë subjekt të këtij plani vlejné përcaktimet e mëposhtme.

Janë të ndaluara:

- Derdhja e hidrokarbureve, ujërave të ndotura, të ujërave të zeza dhe ato sanitare të patrajuara; hedhja e inerteve, lëndëve të tjera të rrezikshme, helmuese, plasëse; të përdorimit apo ruajtjen e plehrave dhe pesticideve bujqësore,
- Hedhja dhe grumbullimi i mbetjeve të ngurta buzë rrugëve dhe në të gjitha hapësirat e tjera veç pikave të përcaktuara për grumbullimin e tyre,
- Gërmimet, guroret, marrja e rërës apo zhavorrit,
- Prerja e bimësisë pyjore,
- Veprimtaritë që çënojnë ndërveprimin harmonik të natyrës me kulturën (mbrojtjen e cilësisë së peizazhit, përdorimin e kontrolluar e të vazhdueshëm të tokës, ujërave, pyjeve, kullotave, bimëve mjekësore, veprimtarive artizanale dhe ato me bazën e turizmit familjar).

Rregulla të tjera:

- lartësia e zhvillimeve nuk duhet të kalojë atë të pishave (lartësia mesatare e pemëve të maturuara), në mënyrë të preferueshme; përjashtimi do të ishte i pranueshëm vetëm për struktura të nevojshme të tipit “landmark”;
- promovimi i një peisazhi pa barriera artificiale duke eliminuar garrdhet ku është e mundur dhe duke i zëvendësuar me breza gjelbërimi aty ku është e nevojshme për të bërë një ndërthurje më organike midis dy sistemeve Natyrë-Bujqësi
- rikuperimi i brezit të gjelbërimit bregdetar me pishat dhe pemët e larta karakteristike të zonës
- mbrojtja nga eropzioni i rrjedhës së lumit për mes gjelbërimit masiv të zonave buferike
- aplikimi i një arkitekture me kërkesa të larta estetike dhe nxitja e aplikimit të materialeve natyrale dhe lokale.

4 KREU IV - Rregullat bazë për infrastrukturën

12 Infrastruktura e transportit

Për zbatimin e infrastrukturës rrugore në zonë vlejné rregullat e përcaktuara nga Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe dokumentit të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë. Sipas dokumentit të PPV-së, infrastruktura rrugore zbatohet sipas detajeve më poshtë:




Figura 1 Autostradë (A)



Figura 2 Rrugë interurbane kryesore (D)




Figura 3 Rrugë interurbane dytësore (C)




Figura 4 Rrugë interurbane dytesore (C)





Figura 5 Rrugë lokale (F)



Rrugë urbane kryesore (D)

Rrugë urbane kryesore (D)




Figura 6 Rrugë urbane dytësore (E)




Figura 7 Rrugë urbane dytësore (E)



Figura 8 Rrugë lokale (F)




Figura 9 Rrugë lokale (F)

Rrugët e brendshme / të shërbimit të secilës njësi parashikohen dhe realizohen sipas projekteve individuale të zhvillimit dhe janë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e zhvilluesve.

Hyrje-daljet nga nënnjësitë, duhet të realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar sigurinë rrugore dhe funksionimin e pasqyrtësuar të trafikut në rrugën kryesore.

13 Infrastrukturat inxhinierike

Infrastrukturat e tjera inxhinierike për aktivitete e lejuara në të gjitha rastet duhet të lidhen me rrjetet ekzistuese.

Në lidhje me infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve, *duhen siguruar burime të mjaftueshme të ujit për plotësimin e nevojave të popullsisë së zonës rurale dhe përballimin e kërkesës për ujë gjatë periudhës së pikut turistik.*

Ndaluar shkarkimi në mjedis i ujërave të ndotur e të patrajtuar. Çdo strukturë ose lokalitet duhet të jetë i lidhur me shërbimin e kanalizimeve dhe impiantin e trajtimit të ujërave të përdorur, ose me gropat septike ekologjike, me kushtet e duhura higjienosanitare.

Në lidhje me furnizimin e energjisë elektrike, inkurajohet planifikimi dhe projektimi i i sistemeve autosuficiente dhe përdorimi i burimeve alternative të energjisë (kryesisht asaj diellore përmes sistemeve fotovoltaike) aty ku është e mundur dhe pacënuar peisazhin karakteristik të zonës. Kërkohen përmirësime të rrjetit të shpërndarjes së eneregjisë elektrike dhe shtim i kapacitetit të rrjetit për të përballuar kërkesën gjatë periudhës turistike.

5 KREU V - Rregullat e zhvillimit për nënnjësitë strukturore

5.1 Njësitë strukturore të Sistemit Urban dhe Infrastrukturor

Njësitë strukturore, pjesë të sistemit urban klasifikohen në:

- Njësi urbane të karakterit banim tradicional, ku përfshihen fshatrat ekzistues të: Akernisë, Poro, Zhukë-Grykëshqipe, Dëllinjë, Bishan, Fitore, novoselë, Aliban, Zërnec dhe Nartë.
- Njësitë urbane të karakterit shërbim-hoteleri, të propozuara nga studimi.

Zonat urbane të përcaktuara sipas pikës a), ruajnë kufirin ekzistues të zhvillimit dhe konsolidohen brenda territorit ekzistues. Parametrat e Zhvillimit për këto zona ruajnë parashikimet e PPV të bashkisë Vlorë.

Zonat urbane të përcaktuara sipas pikës b), janë të propozuara për rizhvillim dhe shoqërohen me kërkesë për ndryshim të kategorisë së përdorimit ekzistues të tokës. Parametrat e përgjithshëm të zhvillimit për këto zona përcaktohen në tabelën e mëposhtme dhe detajohen me lejet e zhvillimit me miratim në KKT, në zbatim të këtij plani.

Të gjitha njësitë e sistemit Infrastrukturor, që nuk janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV të Bashkisë Vlorë.

Përshkrim	Njësi me karakter Infrastrukturor		
Njësia Vendore	Novoselë		
Kodi ZRK.NO.	INT3-01	INT4 -01	S+SHA.01
Sip e njësisë	63.4 ha	135.5 ha	96.4 ha
Mënyra e ndërhyrjes në territor	<u>Rizhvillim</u>		<u>Rizhvillim</u>
Kufizime	Zbatimi i infrastrukturës aeroportuale rrugore dhe portuale kanë prioritet në zbatimin e këtij plani. Te gjitha njësitë kufitare me njësitë e përdorimit infrastrukturë duhet të respektojnë distancat e zones buferike per infrastrukturën rrugore, hekurudhore dhe e aeroportit te ri perkatesisht me gjeresi 50m, 50m dhe 700m.		Të respektohen distancat e zones buferike nga infrastrukturat e propozuara dhendaj brigjeve ujore.
Sistemi baze	Infrastrukturë		Urban
Kategorite baze te përdorimit	Infrastrukturë(IN) dhe Shërbime (S)	Infrastrukturë	Shërbime(S), Aktivitete Shoq.Argetimi(SHA)
Nenkategorite e përdorimit	INT3 Infrastrukturë e Transportit Ujor	INT4 Infrastrukturë e Transportit Ajror	S2 Shërbime Tregtare dhe Biznesi S2-7(Dyqane), AR3-6 (Fushe Golfi)
Tipologjia	Marine Turistike	Aeroport	Golf Resort
Tregues te zhvillimit	Për zbatimin e këtij plani, dhe përcaktimin e vendosjes dhe kriterëve të detajuar për Zhvillimin e Marinës Turistike do të hartohet një studim dhe plan zhvillimi i detajuar	Sipas projektit	Sipas projektit
	NA	NA	NA

Tabela 1 Njësitë strukturore të Sistemit Infrastrukturor




Figura 10 Propozim për nënnjësine INT3 Infrastrukturë e Transportit Ujor

5.2 Njësiti strukturore të Sistemit Ujor

Të gjitha njësiti e sistemit ujor ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV të Bashkisë Vlorë.

- Njësia NO.U.100, me sipërfaqe 31.63 ha
- Njësia NO.U.101, me sipërfaqe 62.70 ha
- Njësia NO.U.103, me sipërfaqe 274.31 ha
- Njësia NO.U.142, me sipërfaqe 765.40 ha
- Njësia NO.U.1514, me sipërfaqe 10.82 ha
- Njësia NO.U.1515, me sipërfaqe 12.08 ha
- Njësia NO.U.1522, me sipërfaqe 11.03 ha
- Njësia NO.U.1523, me sipërfaqe 13.34 ha
- Njësia NO.U.1524, me sipërfaqe 16.08 ha
- Njësia NO.U.1528, me sipërfaqe 6.11 ha
- Njësia NO.U.172, me sipërfaqe 46.14 ha
- Njësia NO.U.177, me sipërfaqe 16.96 ha
- Njësia NO.U.87, me sipërfaqe 116.32 ha
- Njësia NO.U.88, me sipërfaqe 28.32 ha
- Njësia NO.U.90, me sipërfaqe 28.47 ha

- Njësia NO.U.91, me sipërfaqe 1994.38 ha
- Njësia NO.U.94, me sipërfaqe 1563.06 ha
- Njësia QE.N.503, me sipërfaqe 120.48 ha
- Njësia QE.U.104, me sipërfaqe 43.07 ha
- Njësia QE.U.105, me sipërfaqe 96.12 ha
- Njësia QE.U.106, me sipërfaqe 33.70 ha
- Njësia QE.U.118, me sipërfaqe 11.34 ha
- Njësia QE.U.1562, me sipërfaqe 0.01 ha
- Njësia QE.U.1563, me sipërfaqe 0.96 ha
- Njësia QE.U.1564, me sipërfaqe 7.63 ha
- Njësia QE.U.1566, me sipërfaqe 44.22 ha
- Njësia QE.U.1567, me sipërfaqe 39.95 ha
- Njësia QE.U.208, me sipërfaqe 1.30 ha
- Njësia QE.U.92, me sipërfaqe 37.52 ha
- Njësia QE.U.93, me sipërfaqe 84.42 ha
- Njësia QE.U.95, me sipërfaqe 12.18 ha

Në cdo rast, zhvillimi pranë trupave ujorë aplikohen distancat sipas zonave buferike të treguara në hartën e përdorimit të propozuar të tokës:

- Distanca 100m nga bregu i detit dhe bregu i lumit, mbrojtje strikte, ndalohen ndërtimet dhe cdo lloj aktiviteti dhe përdorimi privat që tjetëron territorin, aksesit është i lirë dhe sipas rastit duhet të plotësojë kushtet e sigurisë për jetën e individëve.
- Distanca 300 m nga bregu i detit dhe rrjedha aktuale e lumit të Vjosës, mbrojtje e moderuar, ndalohen ndërtimet e përhershme, mund të aplikohet për leje për struktura të përkohshme, sezonale, me materiale të lehta të cmontueshme, në shërbim të aktivitetit turistik, mbajtjes pastër të territorit përreth dhe sigurisë për jetën e individëve/pushuesëve.

5.3 Njësitë strukturore të sistemit Bujqësor

Të gjitha njësitë e sistemit bujqësor, me përjashtim të atyre të cilësuar në tabelën e mëposhtme, ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV Vlorë.

Përshkrim	Njësi me karakter Bujqësor							
Njësia Vendore	Novoselë	Novoselë	Novoselë	Novoselë	Novoselë	Novoselë	Novoselë	Novoselë
Kodi ZRK.NO.	B - 01	B - 02	B - 03	B - 04	B - 05	B - 06	B - 07	B - 08
Sip e njësisë	433 ha	455 ha	1252 ha	148.4 ha	326 ha	125.3 ha	167.2ha	175.7 ha
Mënyra e ndërhyrjes në territor	<u>Konservim, ruajtje e tokës bujqësore. Zhvillim i kufizuar për struktura në ndihmë të aktivitetit bujqësor sipas legjislacionit sektorial në fuqi.</u>							
Kufizime	Të respektohen distancat e zones buferike për infrastrukturen rrugore, hekurudhore dhe e aeroportit të ri perkatesisht me gjerësi 50m, 50m dhe 700m. Të respektohen distancat e mbrojtjes së vijave ujore e bregore 100 dhe 300m sipas kësaj rregulloreje dhe hartës së përdorimit të tokës.							
Sistemi baze	Sistemi Bujqësor							
Kategorite baze të përdorimit	B-Bujqësi							
Nenkategorite e përdorimit	B1- kultura të përhershme, B2 – kultura të përkohshme, EB1- Fermë bujqësore, IB-Infrastrukturë Bujqësore							
Tipologjia	<u>Peisazh rural, toka bujqësore me infrastrukturë vaditëse dhe kulluese, në disa raste struktura në shërbim të aktivitetit bujqësor.</u>							
Tregues të zhvillimit	Nuk parashikohen ndërtime, me përjashtim të rasteve në përputhje me legjislacionin sektorial për bujqësinë, VKM Nr. 283, datë 1.4.2015 ‘Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore’, Vendimin e KKT nr.12, datë 27.02.2019 ‘Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)’ si dhe VKM nr. 22, datë 12.1.2018 ‘Për miratimin e kriterëve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit’							

Tabela 2 Njësitë strukturore të Sistemit Bujqësor

5.4 Njësitë strukturore të Sistemit Natyror

Të gjitha njësitë e sistemit natyror brenda kufirit të zonës së PDZRK Vojsë-Nartë, me përjashtim të atyre të cilësuar në tabelën e mëposhtme, ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV Vlorë. Në përgjithësi, në njësitë strukturore me përdorim natyrë nuk lejohen zhvillime të asnjë lloji, megjithatë nuk përjashtohen vendosja e strukturave të lehta të përkohshme për ofrimin e disa aktiviteteve dhe shërbimeve pranë zonave të plazhit.

Përshkrim	Njësi me karakter Natyror											
Njësia Vendore	Novoselë											
Kodi ZRK.NO.	N-01	N-02	N-03	N-04	N-05	N-06	N-07	N-08	N-09	NAR2.01	NAR2.02	NAR2.03
Sip e njësisë	355.4 ha	22.8 ha	16.4 ha	74 ha	86.3 ha	20 ha	273 ha	192 ha	129.3ha	73.75	102.37 ha	8.9 ha
Mënyra e ndërhyrjes në territor	Konservim dhe rikuperim mjedisor											
Kufizime	Të respektohen distancat e mbrojtjes së vijave ujore e bregore 100 dhe 300m sipas kësaj rregulloreje dhe hartës së përdorimit të tokës.Të respektohen distancat e zones buferike per infrastrukturen rrugore, hekurudhore dhe e aeroportit te ri perkatesisht me gjeresi 50m, 50m dhe 700m.											
Sistemi	Natyre - N											
Kategoria baze e perdorimit të tokës	Tokë natyrore - N											
Nenkateg.te e perdorimit	N1,N5, NAR1									NAR2		
Tipologjia	Park natyror & Pyll									Plazh		
Tregues te zhvillimit	Nuk Aplikohen											

Tabela 3 Njësitë strukturore të Sistemit Natyror

Përshkrim	Njësi me karakter Natyror dhe Shërbime Ekoturistike			
Njësia Vendore	Novoselë			
Kodi ZRK.NO.	NAR4.01	NAR4.02	NAR4.03	NAR4.04
Sip e njësisë	224.5 ha	329ha	335 ha	114.14 ha
Mënyra e ndërhyrjes në territor	Zhvillime të kufizuara për struktura në ndihmë të aktivitetit turistik që integrohen me përdorimin bazë të natyrës.			
Kufizime	Të respektohen distancat e mbrojtjes së vijave ujore e bregore 100 dhe 300m sipas kësaj rregulloreje dhe hartës së përdorimit të tokës. Të respektohen distancat e zones buferike për infrastrukturen rrugore, hekurudhore dhe e aeroportit të ri përkatësisht me gjerësi 50m, 50m dhe 700m.			
Sistemi	Natyre - N			
Kategoria baze e përdorimit të tokës	Natyre N dhe Shërbime S			
Nenkatëgje e përdorimit	NAR4- Ekoturizëm, S1, S1-6- Bar Restaurant, S1-3 - Bujtina			
Tipologjia	Struktura të lehta, me materiale natyrore, gure në dukje, dru, suva etj.			
Tregues të zhvillimit	Treguesit e mëposhtëm janë orjentues por jo kufizues. Treguesit e detajuar do të përcaktohen në bazë të projektit të zhvillimit, në cdo rast të respektohet legjislacioni sektorial për Zhvillimet ekoturistike dhe agroturistike, VKM Nr. 283, datë 1.4.2015 'Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore', Vendimin e KKT nr.12, datë 27.02.2019 "Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)" si dhe VKM nr. 22, datë 12.1.2018 "Për miratimin e kritereve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit"			

Tabela 4 Njësitë strukturore të Sistemit Natyror dhe Shërbime Ekoturistike

5.5 Njësitë strukturore të Sistemit Bujqësor me shërbime agroturistike.

Përshkrim	Njësi me karakter miks Bujqësor dhe Natyror me përdorime të lejuara të shërbimeve agro dhe eko turistike.				
Njësia Vendore	Novoselë				
Kodi	B.EB3.01		B.EB3.02		
Sip e njësisë	385.5 ha		849.4 ha		
Mënyra e ndërhyrjes në territor	Zhvillime të kufizuara për struktura në ndihmë të aktivitetit turistik që integrohen me përdorimin bazë të bujqësisë dhe natyrës.				
Kufizime	Të respektohen distancat e zones buferike për infrastrukturen rrugore, hekurudhore dhe e aeroportit të ri përkatësisht me gjerësi 50m, 50m dhe 700m. Të respektohen distancat e mbrojtjes së vijave ujore e bregore 100 dhe 300m sipas kësaj rregulloreje dhe hartës së përdorimit të tokës.				
Sistemi	Bujqësi B				
Kategoria baze e përdorimit të tokës	Shërbime(S) + Bujqësi(B) Agroturizëm EB3				
Nenkatëgje e përdorimit	EB3 - Agroturizëm, EB1- Fermë, S1-6- Bar Restorant, S1-3 - Bujtina, NAR4 - Ekoturizëm				
Tipologjia	Struktura të lehta, me materiale natyrore : gure në dukje, dru, etj.				
Tregues të zhvillimit	Treguesit e mëposhtëm janë orjentues por jo kufizues. Treguesit e detajuar do të përcaktohen në bazë të projektit të zhvillimit, në cdo rast të respektohet legjislacioni sektorial për Zhvillimet ekoturistike dhe agroturistike, VKM Nr. 283, datë 1.4.2015 ‘Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore’ Vendimin e KKT nr.12, datë 27.02.2019 “Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)” si dhe VKM nr. 22, datë 12.1.2018 “Për miratimin e kritereve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit”				
Intensiteti i ndërtimit	i = 0.05	i = 0.05	i = 0.05	i = 0.05	i = 0.05

Koef.shfrytez.territorit	k= 5%	k= 5%	k= 5 %	k= 5%	k= 5%
Sip minimale e sugjeruar per nen darje parcelash	5 ha	5-10 ha	5ha	5ha	5ha
Lartesia ne kate	2-3	2-3	2-3	2-3	2-3
Lartesia ne m	sipas projektit				

Tabela 5 Njësitë strukturore të Sistemit Bujqësor me shërbime agroturistike.

Këto njësi kanë përdorim bazë bujqësi dhe natyrë, megjithatë nuk përjashtohen disa aktivitete shërbimi. Territori i këtyre njësive shtrihet në sipërfaqe krejtësisht të pashfrytëzuara dhe shërben si një kalim gradual midis përdorimeve bujqësore dhe turistike. Përgjithësisht janë konceptuar të zhvillohen në formën e fermave të mëdha bujqësore të cilat mund të zhvillojnë aktivitetin e agroturizmit, vinotekave etj. Kështu këto ferma mund të specializohen në prodhimin dhe përpunimin e një proukti të vetëm dhe njëkohësisht të shërbejnë si vende atraksioni për kalimin e kohës të turistëve të zonës apo edhe qytetarëve nga Tirana Vlora dhe më gjerë. Zhvillimi i vinotekave, i fermave me pentari të ndryshme apo të hipizmit etj ...do të shndërrojë zonën jo vetëm në prodhuese por edhe një markë për vendin. Brenda fermave mund të përfshihen aktivitete të shërbimit, restorantit dhe pjesërisht hoteleri për të plotësuar ciklin e aktiviteteve brend apartelave të mëdha që shkojnë nga 5-10ha për territoret më pranë detit deri në 50-100 ha për fashën qendrore të të gjithë zonës në studim.

- 1 *Kategoria bazë* – Bujqësi dhe Natyrë
- 2 *Nënkategoria* - Agroturizëm, Ekoturizëm
- 3 *Funksioni* – Ferma, Bujtina, Bar, Restorant, njësi akomodimi

6 KREU VI - Dispozita kalimtare dhe të fundit

6.1 Monitorimi i zbatimit të PDZRK-së

Referuar Rregullores së Planifikimit të Territorit, procesi i zbatimit të dokumenteve të planifikimit monitorohet nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në bashkërendimin me autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Në këto kushte, AKPT monitoron në vijimësi, zbatimin e kësaj rregulloreje.

6.2 Rishikimi i PDZRK-së

1. PDZRK mbetet i vlefshëm për zbatim deri në momentin kur vlerësohet i nevojshëm rishikimi i tij, i cili mund të iniciohet në mënyrë të pavarur ose si rrjedhojë e rishikimit të plotë të PPV-së.
2. Procesi për rishikimin e plotë apo të pjesshëm të Rregullores dhe të të gjithë dokumentacionit të PDZRK-së, mund të fillojë me kërkesë të autoriteteve publike apo subjekteve private që ushtrojnë aktivitetin në territorin subjekt planifikimi, sipas përcaktimeve të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
3. Procedura e rishikimit të PDZRK-së dhe Rregullores në zbatim të tij realizohet duke ndjekur parimet e Ligjit të Planifikimit dhe Zhvillimi të Territorit si dhe përcaktimet e Rregullores së Planifikimit të Territorit.

6.3 Zgjidhja e Konfliktëve dhe mospërputhjeve

1. Në rast mospërputhjeje të dokumenteve të PDZRK-së me këtë Rregullore, dispozitat e Rregullores kanë përparësi mbi elementët grafikë.
2. Në rast mospërputhjeje të përcaktimeve të kësaj Rregulloreje, me rregullore të tjera kombëtare apo me ligje dhe me standarte, dokumentet e nivelit kombëtar kanë përparësi.

6.4 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore dhe i gjithë dokumenti i PDZRK-së hyn në fuqi, pas miratimit në Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT) dhe botimit të tij në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT).

7 Shtojca I – Referenca Ligjore

Në zbatimin e kësaj rregulloreje duhen mbajtur parasysh përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore si më poshtë:

Akti	Nr.	Datë	Titulli
Ligj	107	31.07.2014	“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar

Ligj	9244	17.06.2004	“Për mbrojtjen e tokës bujqësore” i ndryshuar
Ligj	8752	26.3.2001	“Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar
Ligj	81	04.05.2017	“Për zonat e mbrojtura”
Ligj	91	28.2.2013	“Për vlerësimin strategjik mjedis”
Ligj	10448	14.7.2011	“Për lejet e mjedisit”
Ligj	10431	09.06.2011	“Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar
Ligj	9385	04.05.2005	“Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar
Ligj	8378	22.07.1998	“Kodi Rugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar
Ligj	93	27.07.2015	“Për turizmin”, i ndryshuar
Ligj	27	17.5.2018	“Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”
Ligj	139	17.12.2015	“Për vetëqeverisjen vendore”
Ligj	162	04.12.2014	“Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit”
Ligj	111	15.11.2012	“Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar
Ligj	152	21.12.2015	“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin
Ligj	93	09.11.2014	“Për përfshirjen Sociale dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”
VKM	686	22.11.2017	“Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar
VKM	408	13.05.2015	“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar
VKM	881	14.12.2016	“Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”
VKM	283	01.04.2015	“Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, i ndryshuar
VKM	410	27.06.2012	“Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”
VKM	57	06.02.2019	“Për kriteret dhe mënyrën e zonimit të territorit të një zone të mbrojtur mjedisore”

VKM	153	07.04.2000	“Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar
VKM	352	29.04.2015	"Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të"
VKM	379	25.05.2016	“Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm"
VKM	246	30.04.2014	“Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore"
VKM	797	29.9.2010	“Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes"
VKM	1304	11.12.2009	“Për miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve” Sh.A
Vendim KKT	3	09.12.2017	Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë